

VENDIM
Nr. 599, datë 15.10.2025

PËR NGARKIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT, SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR REALIZIMIN E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT PËR PROJEKTIDETË E ZHVILLIMIT TË KAMPUSIT UNIVERSITAR “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e zhvillimit të kampusit universitar “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

2. Efektet financiare prej 23 665 000 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekësh përballohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit, miratuar për vitin 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama